



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 nëntor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Riklasifikim

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(2) dhe 40(2) dhe (4) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 82 dhe 116(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 25 tetor 2023, Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") dorëzoi një kërkesë për riklasifikim ("Kërkesa"),¹ ku kërkonte riklasifikimin si publik të: (i) Shtojcës 1 të Mocionit të Dytë të Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera ("fakti i propozuar i shqyrtuar në procese të tjera");² dhe (ii) Kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mocionin e Dytë të Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera ("F01819").³

2. Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") nuk iu përgjigj Kërkesës.

II. DISKUTIM

3. Pasi ka shqyrtuar Kërkesën, Trupi Gjykues është bindur se parashtrimi i protokolluar F01819 mund të riklasifikohet si publik. Sa i përket faktit të propozuar të shqyrtuar në procese të tjera, Trupi Gjykues vëren se ai buron nga një aktgjykim i një gjykate vendore në Kosovë,⁴ që është i disponueshëm

¹ F01890, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Riklasifikim*, 25 tetor 2023.

² F01780/A01, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 1 e Mocionit të Dytë të Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 8 shtator 2023, konfidenciale.

³ F01819, Mbrojtja e Specializuar, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mocionin e Dytë të Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 26 shtator 2023, konfidenciale.

⁴ Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P. nr. 215/04, *Aktgjykim kundër të akuzuarve Rustem Dema, Enver Axhami, Ejup Runjeva, Bujar Tafili dhe Nuhi Provoliu ("Aktgjykimi Dema dhe të tjerët")*, 12 maj 2005.

publikisht në formë të redaktuar. Trupi Gjykses vëren se fakti i propozuar i shqyrtuar në procese të tjera përfshin një emër që është redaktuar në versionin e disponueshëm publikisht të aktgjykimit.⁵ Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se nxjerrja e emrit të lartpërmendur mund të çojë në identifikimin e personit përkatës si dëshmitar i ZPS-së, që bie ndesh me qëllimin e parashtrimit prej Mbrojtjes të një versioni të redaktuar publik të Mocionit të Dytë të Mbrojtjes për Konstatim Gjyqsor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera.⁶ Për rrjedhojë, Trupi Gjykses nuk është bindur se fakti i propozuar i shqyrtuar në procese të tjera mund të riklasifikohet si publik. Për këto arsye, Trupi Gjykses: (i) miraton kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për riklasifikimin si publik të parashtrimit të protokolluar F01819; (ii) urdhëron Zyrën Administrative që të riklasifikojë si publik parashtrimin e protokolluar F01819; (iii) hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për riklasifikimin si publik të faktit të propozuar të shqyrtuar në procese të tjera; dhe (iv) urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë një version të redaktuar publik të faktit të propozuar të shqyrtuar në procese të tjera, deri të premten, 24 nëntor 2023.

III. VENDIM

4. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën, pjesërisht;
- b) **URDHËRON** Zyrën Administrative që të riklasifikojë si publik parashtrimin e protokolluar F01819;
- c) **HEDH POSHTË** kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për riklasifikimin si publik të faktit të propozuar të shqyrtuar në procese të tjera; dhe
- d) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë versionin e redaktuar publik të faktit

⁵ Aktgjykimi *Dema dhe të tjerët*, f. 51.

⁶ *Shih* Kërkesën, para. 2; F01780, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocioni i Dytë i Mbrojtjes për Konstatim Gjyqsor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 8 shtator 2023, konfidenciale, para. 14 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 25 tetor 2023, F01780/RED).

të propozuar të shqyrtuar në procese të tjera, deri të premten, 24 nëntor 2023.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 14 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë.